

**VENDIM**  
**Nr. 170, datë 3.8.2018**

**MBI MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT MBI BASHKËPUNIMIN  
E TREGJEVE DITORE TË ENERGJISË ELEKTRIKE MES PALËVE, ENTI  
RREGULLATOR I ENERGJISË SË SHQIPËRISË (ERE), ZYRA E RREGULLATORIT  
TË ENERGJISË TË KOSOVËS (ZRRë), OST SHA, KOSTT SHA**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2; neneve 16 dhe 18; nenit 19, germa e; nenit 56, germa i, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe në kuadër të Memorandumit të bashkëpunimit të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor, mbi zhvillimin e tregut rajonal të energjisë dhe vendosjen e një kuadri ligjor për bashkëpunim të mëtejshëm (Memorandum of Understanding (MoU) of Western Balkan 6 on Regional Electricity Market Development and Establishing a Framework for other future collaboration), nënshkruar në Vjenë, më 27.4.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 3.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi miratimin e Memorandumit të mirëkuptimit mbi bashkëpunimin e tregjeve ditore të energjisë elektrike mes palëve, Enti Rregullator i Energjisë së Shqipërisë (ERE), Zyra e Rregullatorit të Energjisë të Kosovës (ZRRë), OST sh.a, KOSTT sh.a.,

konstatoi se:

- Në kuadër të projektit për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri–Kosovë nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe konsulenca për këtë projekt është draftuar memorandum bashkëlidhur, i cili ka si qëllim të lehtësojë harmonizimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, për sa i përket lehtësimit të procedurave të bashkëveprimit të këtyre tregjeve.

- Palët zotohen të implementojnë projektin nga Programi i iniciativës së 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor (Western Balkan 6; WB6) për integrimin e tregut ditor të energjisë elektrike për të cilin bashkërisht janë përgjegjëse. Objektivi i projektit është implementimi i tregut ditor të energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë në mënyrë efikase.

- Për këtë qëllim, autoritetet rregullatore, ZRRë dhe ERE, zotohen që të vazhdojnë bashkërisht punën për lehtësimin dhe koordinimin të mbikëqyrjes rregullatore, zhvillimin e deklaratave të përbashkëta, dhe udhëheqjen në marrjen e vendimeve të përbashkëta për implementimin e kësaj iniciative.

- Detyrat e përgjegjësitë e ERE-s janë:

- Angazhimi në zhvillimin dhe funksionimin e një tregu rajonal konkurrues në Komunitetin e Energjisë.

- Eliminimi i kufizimeve në tregtimin e energjisë elektrike me vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë zhvillimin e kapaciteteve ndërkufitare të transmetimit.

- Bashkëpunimi me autoritetet rregullatore të vendeve të tjera fqinje, si dhe me Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë për harmonizimin e kuadrit rregullator për zhvillimin e tregut rajonal të energjisë elektrike, përfshirë edhe shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike dhe rregullat për menaxhimin e kapaciteteve të interkoneksionit.

- ERE duhet të garantojë që, Tregtarët dhe furnizuesit e energjisë elektrike, të regjistruar në një shtet tjetër anëtar të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, kanë të drejtë të marrin pjesë në tregun e energjisë elektrike, bazuar në parimet e reciprocitetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë dhe nënshkruajë Memorandumin e mirëkuptimit mbi bashkëpunimin e tregjeve ditore të energjisë elektrike mes palëve, Enti Rregullator i Energjisë (ERE), Zyra e Rregullatorit të Energjisë të Kosovës (ZRRë), OST sh.a, KOSTT sh.a.

2. Për Entin Rregullator të Energjisë (ERE), Memorandumi do të nënshkruhet nga Kryetari.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë Palët për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

# MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

## MBI BASHKIMIN E TREGJEVE DITORE TË ENERGJISË

### ELEKTRIKE

- QERSHOR 2018 -

*Ndërmjet:*

**Enti Rregullator i Energjisë**  
(ERE; Autoriteti Shqiptar Rregullator i Energjisë)

**Zyra e Rregullatorit të Energjisë**  
(ZRRë; Zyra e Rregullatorit të Energjisë të Kosovës)

**OST sh.a.**  
(OST; Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë)

*dhe*

**KOSTT sh.a.**  
(KOSTT; Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut të Kosovës)

*Më poshtë referuar si "Palët"*

## I. QËLLIMI I BASHKËPUNIMIT

Pakoja e Tretë e Bashkimit Evropian (BE) për liberalizimin e sektorit të energjisë dhe në mënyrë më konkrete, Rregullorja (EC) Nr. 714/2009 mbi kushtet për qasje në rrjet për shkëmbimet ndër-kufitare të energjisë elektrike dhe Rregullorja (EU) Nr. 2015/1222, që krijon doracakun për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhim të kongjestionit (përfshirë këtu edhe kodet dhe doracakët tjerë e mbi tregun që dalin nga Pakoja e Tretë), vulosin objektivat e Tregut të Brendshëm të Energjisë Elektrike ("IEM"), për të siguruar mundësi të reja biznesi dhe më shumë tregti ndër-kufitare, dhe në këtë mënyrë të arrijë përfitime në efikasitet dhe standarde më të larta të shërbimit. IEM është implementuar në mënyrë progresive në BE qysh prej 1999 dhe është shtrirë në Komunitetin e Energjisë me themelimin tij më 2006. Të gjitha këto objektiva kontribojnë në një siguri më të lartë në furnizim me energji elektrike, formësim të qëndrueshëm të çmimeve dhe përfitime afatgjata për konsumatorët në BE dhe në përgjithësi në Komunitetin e Energjisë.

BE dhe Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ndajnë të njëjtën objektivë mbi Modelin e Synuar<sup>1</sup> të tregut të energjisë elektrike me shumicë dhe janë zotuar ligjërisht për të liberalizuar, derregulluar dhe integruar tregjet e tyre të energjisë elektrike. Kuadri ligjor dhe rregullativ për arritjen e këtij synimi, është vendosur fort nëpërmjet Pakos së Tretë të energjisë elektrike, përfshirë këtu edhe kodet dhe doracakët relevantë, që përcaktojnë rrugën dhe objektivat e implementimit. Gurëthemel i këtij synimi të shumëfishtë është krijimi, operacionalizimi dhe bashkimi<sup>2</sup> i tregjeve të organizuara ditore<sup>3</sup>. Në Samitin e Ballkanit Perëndimor, të mbajtur në Vjenë më 27 Gusht 2015, shtetet e Ballkanit Perëndimor vendosën të krijojnë operatorë (bursa) për operimin dhe rrjedhimisht bashkimin e tregjeve ditore në një treg rajonal, krijimin e një tregu balancues ndërkufitar si dhe të vënë në shfrytëzim Zyrën për Ankand të Koordinuar<sup>4</sup> për alokimin e kapaciteteve ndërkufitare, që tashmë ekziston. Vendet e Ballkanit Perëndimor (WB6) i bënë ftesë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë që të marrë përsipër drejtimin e zhvillimit të projektit të tregut rajonal të energjisë. Në këtë proces, vendet e Ballkanit Perëndimor janë zotuar për të zbatuar integrimin e tregut të energjisë elektrike nëpërmjet bashkimit të tregjeve të tyre përkatëse të organizuara si tregje ditore. Mbi këtë bazë OST dhe KOSTT, nëpërmjet një burse në pronësi të përbashkët (që pritet të themelohet) që do të administrojnë tregjet e energjisë elektrike ditore të tyre dhe bëjnë hapin e parë drejt integritetit rajonal.

<sup>1</sup> I njohur si 'Target Model' në implementim e sipër në BE

<sup>2</sup> Në kuadër të këtij Memorandumi, me bashkimin e tregjeve nënkuptohet modeli i bashkimit të tregjeve ditore që operohen nga operatorë të definuar si bursave, ku përfshihet edhe alokimi i kapaciteteve ndër-kufitare ditor në një modul tregtimi. Ky model i bashkimit të tregjeve është i njohur si 'market coupling' apo edhe 'implicit allocation'.

<sup>3</sup> Tregu ditor i energjisë elektrike i referohet tregut ku energjia elektrike tregtohet në baza ditore në një treg të organizuar, psh. bursë, ndërsa lëvrohet ditën e nesërme, i njohur edhe si tregu i ditës në avancë apo tregu një ditë para.

<sup>4</sup> 'Coordinated Auction Office in Southeast Europe' e njohur si SEE CAO, me bazë në Podgoricë ku KOSTT dhe OST së bashku me disa TSO tjera janë aksionarë. Kjo zyrë alokon kapacitetin ndërkufitar afatgjatë në mënyrë të koordinuar.

Palët njohin nevojën për të krijuar mekanizma integruar dhe të harmonizuar të tregut për menaxhimin e rrjedhave të energjisë elektrike dhe operimin e gjithë zinxhirit të sektorit të energjisë elektrike. Për Shqipërinë dhe Kosovën kjo karakterizohet me faktin se janë pjesë e ndërlidhur me rrjetin e Evropës Kontinentale, që përcakton strukturën korresponduese të tregut, duke u thirrur mbi objektivat kyçe si, konkurrenca, mos-diskriminimi, siguria dhe qëndrueshmëria afatgjatë e industrisë energjetike, çmime të përballueshme për konsumatorët fundorë dhe investime adekuate dhe efikase.

Bazuar në sa u tha më sipër, Palët janë pajtuar për të intensifikuar punën e përbashkët në drejtim të pjesmarrjes në tregut e integruar Evropian, IEM. Kjo do të arrihet nëpërmjet themelimit të tregjeve ditore të energjisë elektrike në nivelin me shumicë dhe bashkimin e këtyre tregjeve duke zbatuar Modelin e Synuar të BE-së për alokim implicit të kapaciteteve ndër-kufitare dhe praktikave më të mira Evropiane. Duke pasur synim integrimin në tregun Evropian, në kuadër të nismës së WB6 Palët janë dakorduar të përmbyllin këtë "Memorandum Mirëkuptimi", i cili është vazhdimësi e memorandumeve<sup>5</sup> ndërministrorë të përmbyllura më parë.

## II. OBJEKTIVAT E PËRBASHKËTA

Duke qenë se alokimi implicit i kapacitetit ndërkufitar është zgjidhja e zbatuar aktualisht në bashkimin e tregjeve ditore në Evropë në kuadër të të ashtuquajturit "Multi-Regional Coupling" (MRC), rajoni i Evropës Juglindore (EJL) obligohet të ecë mbi këtë bazë në rrugëtimin drejt Modelit të Synuar, i cili është çmim-formësim i bashkuar ditor (i ashtuquajtur "Single Price Coupling" në nivel të BE-së). Për të shmangur ndonjë mos-përputhshmëri me dhe brenda tregut të integruar pan-Evropian, implementimi i këtij mekanizmi duhet të bazohet plotësisht në dizajnin e Modelit të Synuar të BE-së.

Me qëllim të arritjes së objektivave për rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe ngritjes së nivelit të shfrytëzimit të kapaciteteve ndërkufitare ndërmjet tregjeve përkatëse të energjisë elektrike nga ana e aktorëve në treg, Palët shprehin synimin e tyre të përbashkët për të ecur me integrimin e mëtejshëm në tregje të bashkuara ditore dhe alokimit implicit të kapaciteteve transmetuese ndër-kufitare, për kufirin e tyre të përbashkët. Ky bashkëpunimi, do të realizohet në përputhje të plotë me Modelin e Synuar të tregut ditor për menaxhimin e kongjestionëve ndërkufitare dhe shënon hapin e parë drejt bashkimit të mëtejshëm të tregut regional dhe aderimin në MRC. Prandaj, duke pasur parasysh zhvillimet e fundit në rajonin e EJL dhe WB6, si dhe shtrirjen e bashkimit të tregjeve në shumicën e vendeve Evropiane, Palët konsiderojnë si të përshtatshëm shfrytëzimin e modelit të alokimit të njësive të

<sup>5</sup> Memorandumi i Mirëkuptimit i 28 Nëntor 2017 ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, në mbështetje të themelimit të Bursës së Energjisë në Shqipëri e cila do të operojë tregun e energjisë elektrike një ditë para në Shqipëri dhe Kosovë, duke hedhur themelet për bashkimin e tregjeve; dhe Memorandumin e Mirëkuptimit të 29 Mars 2014 ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë (Ministria e Energjisë dhe Industrisë në atë kohë) dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, në mbështetje të integritetit të tregjeve të energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë.

ashtuquajtura "ATC" për menaxhimit të kongestionit ndërkufitar. Në përputhje me këtë, qëllimi i këtij Memorandumi është implementimi i një zgjidhjeje për të bashkuar tregjet e Shqipërisë dhe Kosovës ku energjia elektrike tregtohet në formë të organizuar dhe në baza ditore.

Palët zotohen të implementojnë projektin nga Programi<sup>6</sup> i WB6 për integrimin e tregut ditor për të cilin bashkërisht janë përgjegjëse. Ky projekt është emërtuar WB6.A1.C01 "Projekti për bashkimin e tregut Shqipëri-Kosovë".

Objekti i projektit është implementimi i tregut ditor të energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë në mënyrë efektive dhe me kosto efektive.

Qëllimi i përbashkët i Palëve është zgjerimi i integritetit të tregut në rajonin e EJT dhe WB6 dhe bashkimin e tregjeve në mënyrë pro-aktive.

Palët deklarojnë që integrimi i tregut duhet të përkrahë besueshmërinë e sistemit, risë rendimentin ekonomik dhe ofroj një vlerë të shtuar për shtetet e përfshira dhe më gjerë për rajonin e EJT.

Palët deklarojnë se duke aplikuar ankandit implicit të kapaciteteve ndërkufitare në kuadër të një tregu ditor të bashkuar, që tashmë është në zbatim në shumicën e tregjeve Evropiane, qasja e tyre mbetet në përputhje me Modelin e Synuar Evropian prandaj është në linjë edhe me integrimin e vazhdueshëm të tregjeve dhe me zhvillimet rreth menaxhimit të koordinuar të kongestionëve në EJT.

Palët do të shqyrtojnë mundësinë e fillimit të operimit të tregjeve të organizuara ditore njëkohësisht si tregje të bashkuara për të siguruar një masë likuiditeti dhe konkurrence.

Autoritetet rregullatore, ZRrE dhe ERE, zotohen të mbikëqyrin dhe mbështesin këtë iniciativë, të monitorojnë zbatimin në vazhdimësi në nivelin rregullator dhe që të mbështesin, në kuadër të kompetencave të tyre, KOSTT, OST dhe bursën përkatëse që në mënyrë efektive dhe në kohë të duhur të arrijnë objektivat e përcaktuar më sipër. Ato gjithashtu zotohen të iniciojnë aktivitete për harmonizimin dhe unifikimin, ku nevojitet, të akteve ligjore dhe rregullative.

Me qëllim të eliminimit të pengesave për hyrjen në treg dhe njëkohësisht për të mbështetur likuiditetin e tregjeve të bashkuara ditore, Palët zotohen që t'u mundësojnë pjesëmarrësve në treg, që janë të regjistruar dhe licencuar për veprimtari në tregun me shumicë në njërin shtet, të drejtën e veprimit në shtetin tjetër në përputhje me dispozitat për reciprocitetin dhe njohjen e ndërsjellë të licencave, sikurse përkufizohet në legjislacionet primare të sektorit relevant të të dy shteteve. Për këtë qëllim, autoritetet rregullatore, ZRrE dhe ERE, zotohen që të vazhdojnë bashkërisht punën për lehtësimin dhe koordinimit të mbikëqyrjes rregullatore, zhvillimin e deklaratave të përbashkëta, dhe udhëheqjen në marrjen e vendimeve të përbashkëta për implementimin e kësaj iniciative.

<sup>6</sup> Program i WB6 për integrimin e tregut ditor është zhvilluar nga një komitetit drejtues të themeluar në kuadër të iniciativës WB6 për tregun ditor "Program Steering Committee for Day-Ahead Market Integration".

### III. ORGANIZIMI I BASHKËPUNIMIT

Duke njohur kontributin e iniciativave paraprake, atyre ekzistuese dhe punën e përbashkët ndërmjet palëve kryesore të interesit në Shqipëri dhe Kosovë, Palët kanë rënë dakord që t'i japin një nxitje aktiviteteve ekzistuese dhe bashkërisht me të gjitha palët e interesit të përfshira të definojnë planin për implementimin e objektivit të këtij Memorandumi. Në mënyrë që të garantohet operim dhe menaxhim efikas i punës së projektit, duhet të vlerësohen strukturat dhe aktivitetet ekzistuese dhe duhet të përcaktohet struktura e qartë e projektit në përputhje me objektivat e këtij Memorandumi. Palët zotohen që ti vazhdojnë aktivitetet e tyre në strukturat vijuese:

- a. Një grup i përfaqësuesve të lartë nga ERE, ZrrE, OST dhe KOSTT, me aturitë të deleguar vendim-marrës që lidhet me aktivitetet në kuadër të këtij Memorandumi (Komiteti Drejtues i Projektit, KDP) që si deturë ka mbikëqyrjen e progresit të përgjithshëm dhe mbështet me sukses zhvillimin, implementimin dhe operimin e tregjeve kombëtare ditore në Shqipëri dhe Kosovë dhe njëkohësisht bashkimin të tyre. Duke përfituar nga struktura ekzistuese, ky grup koordinohet nga përfaqësuesit e Ministrive relevante nga Kosova dhe Shqipëria.
- b. Ekipi i Projektit, që përbëhet nga përfaqësuesit e ERE, ZrrE, OST dhe KOSTT; aktivitetet e të cilit do të përcaktohen në bazë të termave ("Terms of Reference" - ToR) të veçanta dhe do të implementohen në një strukturë të dedikuar të projektit; do të raportojë për progresin e implementimit çdo muaj tek PSC.
- c. Grupet ekzistuese apo të formuara të punës për fusha specifike siç janë çështjet teknike, tregtare, ligjore, rregullative dhe operative, bazuar në nevojat e palëve të interesit të përcaktuara nga Ekipi i Projektit.

Në lidhje me mundësimin, lehtësimin, financimin dhe ndarjen e kostove për implementimin e objektivave të këtij Memorandumi, d.m.th. bashkimin e tregjeve ditore të energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë, Palët kanë rënë dakord që:

- ERE, ZrrE, OST dhe KOSTT duhet të bëjnë përpjekje që të ofrojnë dhe shfrytëzojnë burimet e nevojshme njerëzore dhe teknike në dispozicion të tyre,
- Të gjitha kostot individuale të çdo pjesëmarrësi në projekt (p.sh. kostot e personelit dhe kostot e udhëtimit, kostot për adaptimin e sistemeve të IT-së, kostot për sigurimin e të dhënave, etj.) do të mbarten nga vetë pjesëmarrësit në projekt përveç rastese kur kontributi i palës përkatëse konsiderohet si kosto e përbashkët,
- ndarja dhe kompensimi i kostove të përbashkëta duhet të përcaktohet dhe dakordohet në dokumente/marrëveshje të veçanta, dhe
- çfarëdo kostoje e përbashkët shtesë duhet të dakordohet me shkrim nga të gjithë nënshkruesit e përfshirë para se ndokush të detyrohet për to.

Palët kanë rënë dakord që ti besojnë OST-së rolin për organizimin e takimit të ekspertëve të Ekipit të Projektit. Takimi do të thirret nga OST pas koordinimit me

përfaqësuesit nga Ministrinë përkatëse nga Kosova dhe Shqipëria brenda një periudhe prej 30 ditësh pas nënshkrimit të këtij Memorandumi.

Gjitha përgatitjet, si dhe aktivitetet e ekspertëve të Ekipit të Projektit duhet të organizohen dhe menaxhohen duke pasur si synim themelimin e tregjeve ditore dhe bashkimin e tyre gjatë gjysmë së parë të 2019.

Palët kanë për qëllim finalizimin e të gjitha marrëveshjeve të nevojshme në kohë të duhur për implementimin e tregut të bashkuar të Shqipërisë dhe Kosovës në këtë periudhë kohore. Këto marrëveshje duhet të mbulojnë, por pa u kufizuar në: procedurat operative, shfrytëzimin e algoritmit sipas modelit të tregut të bashkuar Evropian (veçanërisht algoritmin e optimizimit EUPHEMIA), obligimet financiare dhe pagesat, përgjegjësitë e përbashkëta dhe individuale si dhe detyrat e monitorimit, publikimit dhe raportimit. Për tu arritur kjo, një marrëveshje kornizë e cila përkufizon të gjitha fushat dhe të gjitha marrëdhëniet kontraktuale që duhet të mbulohen nga marrëveshjet pasuese mund të shërbej si një opsion i besueshëm për të ofruar qartësi rreth mënyrës së implementimit të kësaj iniciative.


Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe pjesëmarrësit e tjerë relevant në tregjet e përfshira do të informohen rregullisht në lidhje me proceset në lidhje me këtë Memorandum.

Palët ruajnë të drejtën për vazhdimin e planeve dhe projekteve ekzistuese ose hapjen e iniciativave të reja individuale rreth zhvillimeve dhe bashkëpunimeve bilaterale në kontekstin e implementimit të tregut të bashkuar ditë në kufijtë e tjerë brenda ose jashtë këtij kuadri.

Kuadri mbetet i hapur për palët e tjera. Nga ky Memorandum nuk mund të përfitohet asnjë e drejtë dhe obligim ligjor.


Memorandumi i Mirëkuptimit është nënshkruar nga personat e autorizuar të Palëve.

Nënshkruar më \_\_\_\_\_

  
Për ERE: Petrit Ahmeti

  
Për ZRrE: BEJAN Selimi

  
Për OST: Alaudin Jakupi

  
Për KOSTT: ILIR M. SHALA, CEO